Vështrim i shkurtër i parafjalëve të vendit dhe roli i tyre i shenjës

Avni Islami[*]

Abstrakti
Parafjalët janë elemente tipike polisemike: ato kanë kuptime të ndryshme, por janë të ndërlidhura në mes tyre. Sipas semantikës kognitive, kuptimi figurativ i parafjalës zgjeron logjikën e saj hapësinore përmes metaforave konceptuale. Në kontekstin pedagogjik këto elemente mund të jenë të dobishme, ngaqë tërheqin vëmendjen e nxënësve dhe atë e bartin te aspekti i parafjalës që ka kuptim hapësinor e që është veçanërisht i rëndësishëm për proceset e metaforizmit. Ky artikull shqyrton mënyrat e mundshme se si analiza kognitive semantike e parafjalëve mund të përdoret për të trajtuar problemet e të kuptuarit dhe lehtëson të kuptuarit e logjikës së panjohur figurative.

Fjalët kyçe: shenja e relacionit, shenjat funksionale, relacioni i puthitur, relacioni i shkëputur, shenja primare, shenja sekondare.

Hyrje

Parafjalët janë pjesë të ligjëratës dhe është vështirë të përkufizohen me saktësi. Për shembull, shumica e atyre që e mësojnë anglishten si gjuhë të huaj, nuk arrijnë lehtë të bëjnë dallimin në mes të "**In the street** " dhe "**On the street**". Është vështirë të sqarohet përse ndodh kjo vështirësi.[1]

Një gjë është interesante, të huajt që e flasin gjuhën angleze e kanë fare të vështirë t'i përvetësojnë parafjalët. Në bazë të një analize të bërë është konkluduar se 90% e të huajve që e mësojnë gjuhën

[*] *Avni Islami, PhD Candidate, Universiteti AAB, Prishtinë. E-mail: avni83up@hotmail.com*

[1] *Randolph Quirk,Ssidney Greenbaum, Geoffrey Leech and Jan Svartvik.* A comprehensive grammar of the english language, Longman, *1985, f. 659.*

angleze, kurrë nuk arrijnë t'i përvetësojnë parafjalët si duhet.[2] Vetëm 10% janë të suksesshëm në përvetësimin e tyre, ndërsa anglezi i rëndomtë mund të bëjë çfarëdo lloj gabimesh, qoftë sintaksore, semantike apo morfologjike, por në asnjë mënyrë nuk do t'i përdorë parafjalët gabimisht. Gjithashtu, është interesante të përmendet se fëmijët të cilët e kanë anglishten gjuhë amtare, arrijnë t'i përvetësojnë format parafjalore me vonesë dhe me shumë vështirësi. Kjo nxënie realizohet gjatë zhvillimit të tyre në moshën parashkollore, përmes lojërave dhe aktiviteteve të ndryshme.

Parafjalët dallohen nga njëra-tjetra përmes një kombinim kontrasti dhe reciprok të shenjave semantike.

Të kuptuarit e parafjalëve konsiston në kompleksitetin semantik të shenjës e cila përbëhet nga <u>një shenjë e relacionit</u> dhe <u>shenjat funksionale</u> që veprojnë mbi objekte. Shenjat janë koncepte që krijojnë perceptime në mendjen e folësit dhe se këto janë semantikisht të spikatura. Folësit e një gjuhe duhet patjetër të përvetësojnë perceptimet e rëndomta në hapësirë dhe se pajtohen me komponentin vizual të objekteve në hapësirë. Dëgjuesi është i përgatitur të zgjedhë fjalët dhe parafjalët e duhura në vorbullën e madhe gjuhësore për t'iu përgjigjur bashkëbiseduesit, një shenjë e relacionit dhe shenjat funksionale që veprojnë mbi objekte.

Shenjat janë koncepte që krijojnë perceptime në mendjen e folësit dhe se këto janë semantikisht të spikatura. Folësit e një gjuhe duhet patjetër të përvetësojnë perceptimet e rëndomta në hapësirë dhe se pajtohen me komponentin vizual të objekteve në hapësirë. Dëgjuesi është i përgatitur të zgjedhë fjalët dhe parafjalët e duhura në vorbullën e madhe gjuhësore për t'iu përgjigjur bashkëbiseduesit. Parafjalët paraqesin tërësi kognitive të një kontingjenti kulturor me perceptime vizuale. Fare nuk e kemi idenë se si arrijmë t'i perceptojmë këto, por mund të themi se atë që e perceptojmë është varësi kulturore.

---

[2] Douglas Biber, Susan Conrad and Geoffrey Leech. *Students Grammar of Spoken and Written English*, Pearson education, Harlow, Essex, 2002, f.47.

Vështrim i shkurtër i parafjalëve të vendit dhe roli i tyre i shenjës

Vështirësitë që hasen te të huajt në nxënien e parafjalëve në gjuhën angleze ndahen në dy grupe:

a) e para vështirësi është struktura e përgjithshme e shenjave e cila dallon nga gjuha në gjuhë, megjithëse bërthama e përbashkët e shenjave të tilla haset në të gjitha gjuhët,
b) e dyta, është kombinimi minimal i shenjave i cili dallon një parafjalë nga parafjala tjetër në një gjuhë të caktuar.

Parafjalët janë elemente të ndjeshme gjuhësore që në aspektin kulturor janë fare mirë të pranueshme dhe shumë të njohura nga të gjithë anëtarët e një komuniteti të njëjtë gjuhësor.

Me siguri, kjo është një veçori e parafjalëve që fëmijët e cilido komunitet gjuhësor i mësojnë me vonesë.

Fëmija së pari duhet të mësojë tërësinë semantike kognitive të parafjalëve në gjuhën e tij. Me fjalë të tjera, ai së pari duhet t'i mësojë shenjat e sistemit para se të mund t'i përdorë ato. Në këtë rast shenjat janë komplekse, kështu që detyra e nxënies së parafjalëve nga fëmija është e dyfishtë. Ai duhet të mësojë përmbajtjen e secilës shenjë dhe madje të mësojë mundësinë kombinatorike të tyre. Por, si nxihen këto dy elemente nuk na është e fare e njohur.

Sipas kësaj teorie propozohet një grup i shenjave semantike përmes së cilave parafjalët e gjuhës angleze si pjesë përbërëse të sintagmave parafjalore të vendit i nxisin folësit t'i konceptojnë lidhjet mes objekteve**.**

Megjithatë, vështirësia që paraqitet te të huajt në përdorimin e saktë të parafjalëve të anglishtes, në krahasim me pjesët e tjera gramatikore, është shumë evidente, ngaqë të huajt që flasin anglisht përdorin shenja të ndryshme semantike, edhe pse ca nga këto kanë tipare të njëjta me të gjitha gjuhët. Vështirësia më e madhe është në lëmin e semantikës dhe assesi në atë të sintaksës.

Të huajt që merren me anglishten duhet t'i mësojnë disa tipare vizuale të parafjalëve si dhe disa kombinime të domosdoshme, ca nga

të cilat kanë shumë afërsi me parafjalët e gjuhëve të tyre amtare.[3] Por, kjo ngjashmëri shpeshherë e bën nxënien e tyre shumë të vështirë. Për shembull, ne shqiptarët gjatë nxënies së gjuhës angleze e kemi të vështirë të bëjmë dallimin në mes të parafjalëve 'on' dhe 'over' ose 'on' dhe 'above'. P.sh. sintagma e shqipes "Llamba mbi tavolinë" në gjuhën angleze do të përdoret në dy mënyra me kuptime të ndryshme, p.sh. "The lamp on the table" dhe "The lamp above the table". Në sintagmën e parë, sipërfaqja e poshtme e llambës qëndron e puthitur me sipërfaqen e tavolinës, ndërsa në të dytën, llamba qëndron mbi sipërfaqen e tavolinës por pa e prekur atë.

Shqiptarët e kanë vështirë të bëjnë dallimin në mes të parafjalëve 'in' dhe 'at' në anglishte, meqë këto dy koncepte në shqipe shpesh rezultojnë në parafjalën 'në'.

Një brengë serioze e psikologjisë së perceptimit është se si disa veçori të konturave përcaktojnë formën e parafjalës. (Gibson, 1950)[4] .

Dëgjuesi i përshtatet prezantimit të paraqitjes së objekteve konform konceptualizimit të objektit të shprehur përmes parafjalëve. Ky adaptim ndryshon në mesin e folësve dhe reflektohet në interpretim. Si rrjedhim, disa folës e gjejnë kuptimin e ndonjë sintagme të çuditshme në bazë të parafjalës që e hasin.

Përshkrimi i shenjave

Natyra e përshkrimit semantik mbështetet në shenjat semantike, të cilat janë simbole të qarta dhe u referohen koncepteve të tyre. Shenja semantike është simbol i rëndomtë që i referohet konceptit. Një mori e shenjave parësore është dhënë së bashku me përshkrimin dhe i referohen interpretimit të shenjave parësore.

Përkufizimi i fjalës është dhënë përmes specifikimit të shenjës komplekse që është kombinimi i shenjës parësore. Metoda e kombinimit gjithashtu ka interpretim të caktuar, si e tillë, shenja

---

3 Rodney H, and Geoffrey P. *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press, 2002, f.130.

4 *Gibson, J. J.* The Perception of the Visual World, Houghton Mifflin Company, Cambridge, Massachusetts, *1950, f.10*

komplekse i referohet kompleksitetit të dhënë për konceptin dhe kjo është si rezultat i evoluimit të shenjës komplekse që del nga koncepti i shenjës parësore.

Për shembull, shenja (nocioni) **"njeri**," (njeri është shenjë parësore) interpreton veçoritë e krijesës njerëzore. Shenja "**i ri**, **e re**," janë shenja parësore) interpretojnë veçoritë e të qenit në fazën e hershme të ekzistencës së njeriut. Prandaj, kombinimi njeri dhe i ri, apo e re, shpreh konceptin kompleks të fjalës "**fëmijë**".[5] Shembujt e dhënë nxjerrin konceptet e veçorive të caktuara.

Koncepti gjithashtu mund të jetë relacion me dy apo më tepër argumente dhe këto argumente mund të jenë edhe koncepte edhe veçori (p.sh., objekte fizike apo konfiguracione hapësinore). Pra, koncepti i **V** (vendit) është relacion i dy objekteve:[6] **K (Kokës)** dhe **PR (Pikës së Referimit)** dhe mund të simbolizohet përmes shenjës semantike **V(K,PR)**. PR interpretohet si vend, **K** është subjekt ose objekt fizik apo konfiguracion hapësinor, ndërsa **PR** është **V** (vend) i **K**.

Dallimi në mes të vendit dhe pikës se referimit qëndron në atë se vendi është hapësirë më e gjerë se pika e referimit dhe se pika e referimit qëndron brenda hapësirës së vendit.

Kombinimi i shenjave të relacionit si dhe shenjave funksionale do të ketë interpretime të ndryshme. Për shembull, **V (K dhe (PR)** janë në marrëdhënie të përhershme lidhshmërie.

Parafjalët e vendit, ndryshe nga emrat dhe mbiemrat, specifikojnë relacionin dhe konceptet në mes tyre me dy apo me më tepër argumente.

Në përgjithësi, kuptimi i parafjalëve duhet të jepet brenda kornizave të shenjave të relacionit dhe shenjave të funksionit. Parafjalët e vendit i saktësojnë marrëdhëniet hapësinore në mes të një grupi të vogël të karakteristikave të objekteve kur është fjala për trajtimin e tyre. Sidoqoftë, kuptimi i parafjalëve mund të analizohet,

---

[5] Charles Hocket. *A Course in Modern Linguistics*, Macmillan, New York, 1958, f.83.

[6] Douglas Biber, Susan Conrad and Geoffrey Leech. *Students Grammar of Spoken and Written English*, Pearson education, Harlow, Essex, 2002,f.102.

së pari me **konceptet e funksionit** të cilat nxjerrin karakteristika relevante për t'u lidhur dhe së dyti, me **konceptet e relacionit** që përshkruajnë marrëdhënie të veçanta në mes të vlerave të funksioneve. Shenjat komplekse që kanë koncepte funksionale i shënojmë me inicialet **(K)** për **kokën, (PR)** për **pikën e referimit**, ndërsa (**R) relacioni** dhe **V** për vendin (koncepte të relacionit) bëjnë lidhshmërinë në mes të objekteve dhe vendeve. [7]

Shenjat

1. **V (vendi), (K (koka), PR (Pika e referimit)**. (**PR** është lokacion (vend) i **K**). **V (vendi i përgjithshëm**) është relacion i objektit dhe vendit që nuk ndryshon kur **PR** është vend i **K**. **PR** mund të jetë qoftë vend i saktë, ose mund të jetë vëllim, sipërfaqe, apo linjë që përcakton vendin e saktë të **K**. Pra, **V** është koncept i përgjithshëm i vendit të saktë. Kështu, pra mund të themi; [8]

a) 'Mr. Jones' home is located **in** Cambridge".

2a) (K, PR)(Koka P (puthitet) me **PR). P** (puthitja) krijon relacion në mes të sipërfaqes së **K** (kokës) dhe **PR** (Pikës së referimit). Relacioni i puthitjes në mes të kokës dhe pikës së referimit nuk ndryshon në asnjë mënyrë format e këtyre dy objekteve. Ky koncept është i zbatueshëm kur kontakti ose afërsia janë pjesë e të dy figurave dhe jo kur kontakti ose afërsia është vetëm në një pikë.

2b) Ndarje (K, PR) (K dhe PR nuk janë të puthitura, por të ndara). Kontrasti në mes të puthitjes dhe ndarjes do të hyjë në veprim për të bërë dallimin në mes të parafjalëve, siç janë: **"on", "near", "on the top of"**, dhe "**above**". Për shembull, nëse lapsi vendoset horizontalisht mbi hapësirë të tavolinës dhe është në kontakt me sipërfaqen e saj, (lapsi mbi tavolinë është i puthitur me sipërfaqen e tavolinës) do të themi "The pencil on the table", ose "The pencil **on top of** the table". Por, nëse pohojmë se lapsi gjendet në hapësirë mbi tavolinë, pa e prekur atë, (pandehim se lapsi është i varur përmes një spangoje nga

---

[7] Seth Lindstromberg. *English Prepositons Explained*, John Benjamin`s, Longman, 1987, f.102.

[8] Vep. Cit. Quirk, f.118.

plafoni dhe nuk e prek sipërfaqen e tavolinës), themi "The pencil is **above** the table".

3) Sipërfaqja (S) (K) (S) është një strukturë e pikave, vijave dhe sipërfaqeve që shënojnë kufijtë e K). Nëse K është formë tredimensionale (p.sh., vëllim), **S (K)** është grup i sipërfaqeve që përkufizon apo përcakton atë formë. Nëse **K** është dydimensionale (p.sh., sipërfaqe), **S(K)** është një grup i pikave ose konturave që përcaktojnë kufirin ose skajin e sipërfaqes. Dhe, nëse K është njëdimensional (p.sh., vije ose pika), atëherë S(K) është strukturë e pikave e fundit e vijës apo pikave.

Në rast se K është sipërfaqe ose linjë e mbyllur (dhe si rrjedhojë nuk ka skaj apo pika të fundit, si për shembull, guacë sferike ose rreth), themi se **S(K)** është e zbrazët. Nëse **K** është një formë e kutisë , atëherë **S(K)** është grup i linjave që formojnë këndet e kutisë.

Konkluzioni

Roli i shenjës semantike te parafjalët e vendit është element qenësor. Shenjat komplekse semantike të kombinuara me shenjat parësore nuk janë të një rëndësie të vogël gjithashtu.

Koncepti i V (vendit) si lidhje e dy objekteve: K (Koka) dhe PR (Pika e referimit), mund të simbolizohen me shenjat semantike të V (vendit), K (Kokës) dhe PR (Pikës së referimit). PR interpretohet si vend i K. Dallimi në mes lokacionit dhe pikës së referimit është se vendi përfshin (por jo gjithmonë) një hapësirë më të madhe të pikës së referimit, por pika e referimit gjendet gjithmonë brenda hapësirës së vendit, gjegjësisht vendit. Kombinimi i shenjave të relacionit me simbolet funksionale gjithmonë ka interpretime të ndryshme, p.sh. V, K dhe PR janë në lidhshmëri permanente në mes tyre. Parafjalët e vendit, përkundër emrave dhe mbiemrave specifikojnë marrëdhënien dhe konceptet në mes tyre me dy apo më tepër argumente.

Parafjalët e vendit të anglishtes dhe të shqipes dallojnë shumë në mes tyre, ngaqë parafjalët e vendit të shqipes na dalin më tepër polisemike (me shumë kuptime) se ato të anglishtes.

Bibliografi

Clifford, B. *Prepositions in French and English.* New York: Richard R. Smith. 1947.

David, Benet C. *Spatial and Temporal uses of English Prepositions.* Longman. 1975.

Douglas, Biber.Susan, Conrad & Geoffrey, Leech. *Students Grammar of Spoken and Written English.* Pearson Education. Harlow, Essex. 2002.

Rodney. H. Geoffrey, P. *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press. 2002.

Hockwt, Charles. *A Course in Modern Linguistics.* Macmillan. New York: 1958.

Gibson, J.J. *The Perception of the Visual World.* Houghton Mifflin Company. Cambridge- Massachusetts. 1950.

Lyons, John. *Introduction to Theoretical Linguistics.* Cambridge University Press. Cambridge: 1986.

Manfred, Bierwisch. "Some semantic Universals of Locative prepositions". *Foundations of Language.* Vol.3, No.1.

Bowerman, M. & Pederson, *E. Cross-linguistic perspectives on topological, spatial relations.* Longman: 1992.

Quirk, Randolph. Greenbaum, Sidney. Leech, Geoffrey & Svartvik, Jan. *A Comprehensive Grammar of theEnglish language.* Longman: 1985.

Lindstromberg, Seth. *English Prepositons Explained, John Benjamin`s.* Longman: 1987.